



C.nr.1014/17

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil**, me gjyqtarin Misin Frangu, me zyrtaren ligjore Albana Ajvazi, në çështjen e inicuar me padinë e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime, kundër të paditurës Spitali Rajonal në Ferizja, të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED]-shef i personelit, në çështjen juridike pagesë e pagave përcjellëse dhe jubilarë, në seancë e mbajtur me datë 22.10.2018 merr këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **-në bazë të pohimit-**

**I.APROVOHET**, në tërësi kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime, si e bazuar.

**II.DETYROHET**, e paditura Spitali Rajonal në Ferizja, që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej **1.250.00 € (një mijë e dyqind e pesëdhjet euro e zero cent)**, të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj paditësit, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

**III. Secila pale i bartë shpenzimet e veta procedural.**

### **A r s y e t i m i**

Paditësi me datë 08.11.2017 ka parashtruar padi kundër të paditurës Spitali Rajonal në Ferizja, lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit. Paditësja ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura, në vendin e punës si mirëmbajtës i nxemjes qëndrore në Spitalin Rajonal në Ferizaj, deri me datë 07.10.2017, ku sipas fuqisë ligjore iu është ndërprerë mardhënia e punës për shkak të arritjes së moshës të pensionimit. Pas marrjes së vendimit për pensionim, paditësi ju është drejtuar të paditurës si ish pundhënëse me kërkesë që t'ia paguaj një pagë jubilarë për punën mbi 18 vite e të cilat kërkesa këto janë të parapara me nenin 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës dhe kompensimin e pagesës përcjellëse në vlerë të tri pagave në tre muajt e fundit, e cila kërkesë është refuzuar si e pa bazuar.

Paditësi në seancën dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara në shqyrtimin e sotëm gjyqësor dhe deklarata e përfaqësuesit të palës së paditur është vërtetuar se kërkesëpadia është e bazuar në ligjë andaj i propozoj gjykatës që ta obligoj të paditurën që të paguaj tri paga me rastin e pensionimit në shumë prej 1.250 €.



Përfaqësuesi i palës së paditur në seancë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e kundërshtojmë kërkesëpadinë e paditësit sepse e njehta ka bazë ligjore duke u mbështetur në Ligjë dhe Kontratë kolektive e cila ia njeht të drejtën e tri pagave përcjellëse pas pensionimit, andaj në bazë të provave të administruara i propozoj gjykatës që të nxjerrë aktgjykim meritor në bazë të provave të prezantuara.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të pohuar duke qenë se në mes palëve ndërgjygjëse nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se i padituri respektivisht përfaqësuesi i përkohshëm shprehimisht ka pranuar kërkesëpadinë dhe në anën tjetër, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e cila do të pengonte aprovimin e kërkesëpadisë dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadisë nga ana e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit, ndaj në kuptim të nenit 148 të LPK-së, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit, *(në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimin në bazë të pohimit).*

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.1014/17 datë 22.10.2018



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më 26 12 2018  
Dana

